



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2671 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 20.04.2017 merr:

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-MARS PËR VITIN 2017

I

Kuvendi i komunës miraton raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar -Mars për vitin 2017.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar-Mars 2017 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2017 është në shumë prej 2,406,534.00 €. Në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 340,691.82 € apo 24.45 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 14,126.78 € apo 7.82 %, në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shpenzimi është në shumë prej 10,774.81 € apo 24.20 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 5,150.00 € apo 10.08 %, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 17,602 € apo 2.39 %. Totali i shpenzimit është në shumë prej 388,345.41 € apo 16.14 %. Të hyrat vetanake për periudhën Janar-Mars janë arkëtuar në shumë prej 33,488.70 € apo 13.96%.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 20.04.2017



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava